

Evente & Marketing

- Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918 çelet me mbështetjen e SIGAL UNIQA
- Siguracionin e shtëpisë tanimë mund ta blini edhe online
- SIGAL ChatBot-Aplikacioni më i ri i SIGAL UNIQA për klientët në Facebook

Tregu i Sigurimeve

- Të dhënat nga AMF për tregun e sigurimeve për vitin 2017, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

Evente & Marketing



“Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918” çelet me mbështetjen e SIGAL UNIQA

“Monarkia Austro-Hungareze dhe Shqipëria 1916-1918” titullohet ekspozita e çelur në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar e mundësuar nga SIGAL UNIQA Group Austria dhe e realizuar në kuadër të vitit kulturor Austri-Shqipëri 2018.

Ekspozita paraqet dokumente historike dhe imazhe fotografike të Shqipërisë dhe monarkisë austro-hungareze gjatë viteve 1916-1918. Këto imazhe të Shqipërisë së asaj kohe realizuar nga ushtarët dhe regjentët austriakë, rikujtojnë një marrëdhënie që ka lënë gjurmë në historinë e dy popujve.

Kjo ekspozitë do të qëndrojë e hapur gjatë gjithë muajit shkurt.

Në kuadër të këtij eventi, u zhvillua edhe konferenca dy ditore, me pjesëmarrës akademikë nga Austria dhe Shqipëria, të cilët kujtuan ngjarjet e atyre viteve, ngjarje të cilat formojnë dhe influencojnë marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve.

Konferenca shkencore trajtoi gjithashtu tema të tilla si: “Anaksim ose protektorat” dhe “ndikimin austriak në infrastrukturë, politikë, administratë, ekonomi, kulturë dhe arsim” etj.

Siguracionin e shtëpisë tanimë mund t’a blini edhe online

SIGAL UNIQA është e para kompani që futi në treg blerjen online të siguracioneve, duke e nisur si fillim me siguracionet e automjeteve dhe shëndetit në udhëtim.

Tanimë gama e produkteve të sigurimit që mund të blihen online është zgjeruar. Së fundmi u realizua blerja online e sigurimit të shtëpisë.

Çdo individ i interesuar për të siguruar apartamentin apo vilën e tij mund ta bëjë shumë thjeshtë. Mjafton të shkojë tek fq salessigal.com.al, përzgjedh opsionin e sigurimit të apartamentit/vilës, vendos të dhënat që i kërkohen së bashku me një foto të shtëpisë dhe sigurimi kryhet brenda pak sekondave. Në adresën e e-mailit çdo individ i siguron online shtëpinë i shkon edhe polica e sigurimit.

SIGAL ChatBot-Aplikacioni më i ri i SIGAL UNIQA për klientët në Facebook

Aplikacioni më i fundit i SIGAL UNIQA vjen këtë herë për klientët tanë që na shkruajnë në rrjetin social Facebook.

SIGAL ChatBot është një program robotik, i cili u përgjigjet në mënyrë automatike klientëve që shkruajnë në inbox-in e facebook-ut të SIGAL.

Ky program ka për qëllim optimizimin e shpejtësisë së kthimit të përgjigjeve klientëve, duke i ndihmuar ata me informacionet bazë mbi sigurimet.

Në rastet kur klienti nuk merr informacionin e plotë nga ChaBot-i, kontaktohet nga stafi për t’i shpjeguar dhe dhënë informacion mbi atë që i nevojitet.

Tregu i Sigurimeve

Të dhënat nga AMF, SIGAL UNIQA udhëheq tregun

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e para në tregun e sigurimeve, me rreth 30% të tregut.

Nga të dhënat e publikuara nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për vitin 2017, SIGAL vazhdon të udhëheqë tregun duke zotëruar përkatësisht:

61.39% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Jetës;

26.31% të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimin e Jo-Jetës

21.88% të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike;

39.37% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Pasurisë;

33.52% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Aksidenteve dhe Shëndetit

32.28% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Shëndetit në Udhëtim për shoqëritë Jo-Jetë.

39.25% të volumit të përgjithshëm të primeve në Sigurimin e Sëmundjeve për shoqëritë Jo-Jetë.

Sipas AMF, tregu rezulton me një rritje me 5.38% më shumë se viti 2016. Primet bruto kapën shifrën 16.194 miliardë lekë. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1.261.238 me një rritje prej 11.99 % krahasuar me vitin 2016.